

# Edukim në ndërtimin e strategjive për menaxhimin e rasteve kundër ekstremizmit të dhunshëm

Projekti: Parandalimi dhe Riintegrimi i Sigurt: Qasje Holistike dhe Qëndrueshmëri ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

Dr. Mirela Karabina



# Synimi i trajnimit

- Ndihma për drejtuesit arsimorë, mësuesit dhe stafin psiko-social të sistemit arsimor të kuptojnë rolin e tyre dhe rëndësinë e programeve edukuese për të ndihmuar të rinjtë të rezistojnë propagandës së ekstremizimit dhe të rinjve të rikthyer nga zonat e konfliktit për t'u kthyer në normalitet.



# Objektivat e trajnimit

Në fund të trajnimit pjesëmarrësi:

- Të përcaktojë rolin e shkollës gjithëpërfshirëse në edukimin e nxënësve të ardhur nga mjedise dhune dhe ekstremiste;
- Të zbatojë strategji vepruese, teknika të përshtatshme nga ana profesionale për të trajtuar ankthi, traumën, dhunën fizike dhe psikologjike, mungesën e socializimit të fëmijëve të kthyer nga zona lufte.
- Të hartojë strategji ndërhyrëse në mbështetje të fëmijëve;
- Të listojë masa parandaluese dhe mbështetës në studimin e rasteve konkrete.

# Zhvillimi i trajnimit

- **Metodologjia:** Paraqitje njohurish, raste studimore, ushtrime nxemje, punë në grupe, diskutime, feedback.
- **Mjetet e nevojshme:** Flipcharts, markes, ngjitës, materiale te fotokopjuara, Poëer Point, fletë A4.
- Koha në dispozicion 2 orë.
- Ushtrime nxemje 10 min
- Stuhi mendimesh 15 min
- Shkolla gjithëpërfshirëse, dhuna, çrregullimet nga trauma tek fëmijët të ndikuar nga ekstremizmi dhe të kthyer nga lufta.
- Ushtrime në grupe 10 min (evidentimi i rasteve te dhunes dhe fëmijëve të traumatizuar )

# Zhvillimi i trajnimit

- Paraqitja e grupeve, 15 min
- Evidentimi, trajtimi dhe mbështetja nga shkolla e fëmijëve të kësaj kategorie, raste studimore 25 min
- Punë në grupe, 15 min (rast konkret dhe zgjidhja specifike)
- Diskutim rreth tyre, 10 min
- Feddback I trajnimit, 10 min









© Getty Images/AFP





# Një nënë (Tafilja) e kthyer nga lufta thotë :

- “Tash nuk ka zhurma, nuk ka luftë, nuk ka bombardime dhe janë duke u rritur si të gjithë fëmijët e tjerë. Kur vjen prej një vendi ku zhvillohen luftëra, ku gjatë gjithë kohës ka pasur luftime, atëherë normalisht që nuk presim dikë që do të vijë në gjendje normale, pa asnjë problem. Por, kemi hasur në probleme që janë të natyrës dhe që i përgjigjen stresit post-traumatik- PTSD, të cilat zakonisht përjetojnë dhe përfitohen në vendet ku ka luftime të ashpra”, thotë ajo.

# Gjithëpërfshirja, trauma, dhuna, ekstremizmi

- Shkollat gjithëpërfshirëse promovojnë dhe sigurojnë edukim dhe arsimim për të gjithë fëmijet pa marrë parasysh kushtet e tyre fizike, intelektuale, shoqerore, emocionale dhe gjuhësore.
- Synimi është që shkolla të jete një vend ku çdo fëmijë apo nxënës të ketë mundësi të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor
- Cdo nxënës ka aftësi dhe interesa të ndryshme ndaj dhe mësuesi duhet të ketë informacionin e duhur në lidhje me nevojat e tyre.

# Shkolla gjithpërfshirëse respekton:

- Përfshirjen, edukimin dhe arsimin e çdo nxënësi;
- Eliminimin e pengesave të çdo nxënësi në të nxënë;
- Rritjen e pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor;
- Planifikimi i mësimdhënies duke marr parasysh nevojat e secilit nxënës në klasë.
- Nxënësit janë të përfshirë në mënyrë aktive në mësimdhënie.
- Mësuesit planifikojnë dhe vlerësojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin.
- Mësuesit dhe gjithë personeli bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

# Çfarë është trauma?





# Trauma

- Një ndodhi që na e kërcënon jetën dhe mirëqenien quhet *traumë*. Fjala “traumë” përdoret për të emërtuar edhe ndodhinë, edhe mënyrën sesi ajo përjetohet.
- Që në muajt ose vitet e para, jeta e një fëmije mund të vihet në rrezik nga ngjarje tronditëse: një katastrofë natyrore, një aksident, ndarja e prindërve apo humbja e një prindi. Krahas këtyre ngjarjeve *episodike* (që ndodhin vetëm një herë), një fëmijë mund të tronditet edhe nga ngjarje *kronike* (që ndodhin në mënyrë të përsëritur): dhuna në familje, keqtrajtimi dhe neglizhimi, vizitat në spital dhe ndërhyrjet mjekësore.
- Për fat të keq, shoqëria jonë e ka shpërfillur rëndësinë e traumave në fëmijëri. Ende, edhe sot, shumë njerëz besojnë se fëmijët “harrojnë” apo se “e marrin veten shpejt” nga ngjarjet e dhimbshme.

# Si ta kuptojmë nëse fëmija ka përjetuar traumë?

- Shenjat më të zakonshme janë: ndryshimet në oreks, vështirësia për të fjetur, makthet, ndjenjat e zemërimit, frika e jashtëzakonshme dhe reagimet e alarmit. Fëmijët e përsërisin shpesh skenën e ngjarjes në lojë. Këto janë sinjale që tregojnë se fëmija mund të ketë përjetuar një trauma.
- **Kujt t'i drejtohem nëse kemi dyshime?**
- Të parët, prindërit, duhet ta çojnë fëmijën për një vlerësim psikologjik te një profesionist i shëndetit mendor.
- stafet e institucioneve të kujdesit dhe edukimit, të cilët duhet të raportojnë te psikologu, punonjësi social ose mjeku i institucionit, shpesh edhe te organet e rendit. Pas vlerësimit të fëmijës nga një psikolog i licensuar, prindërit dhe aktorët e tjerë në jetën e fëmijës duhet të bashkëpunojnë me psikologun/psikoterapistin e fëmijës në çdo hap gjatë procesit të terapisë.

# Si ta trajtojmë?

- Për klientët e vegjël, metoda është përshtatur nga shumë kërkues dhe psikologë klinikë në botë, EMDR.
- Në fazën e parë, ne njihemi me historinë e fëmijës dhe vlerësojmë aspekte si moshën, niveli i zhvillimit, kontekstin ku jeton, përvojat e jetës, aftësinë për të toleruar emocionet, stabilitetin e tanishëm dhe ngjarjet traumatike që ka përjetuar.
- Në fillim të terapisë, vendosim “vendin e sigurisë”. Për fëmijët, vendi i sigurisë është një kujtim shumë i bukur që ata kanë.
- Më pas, fëmijës i shpjegohet EMDR me një gjuhë të thjeshtë dhe në përputhje me moshën e zhvillimin.

Për shembull, mund t’i themi: “Kur ne na ndodhin gjëra të shëmtuara, na përzihen ndjenjat dhe mendimet. Ne nuk ndihemi mirë: mendja, zemra dhe trupi ynë nuk ndihen mirë. Sikur mbajmë një çantë të rëndë në shpinë. Kur mbajmë një çantë të rëndë, ne nuk kemi vend as në mendje, as në zemër, as në trup, për ndjenja dhe mendime të mira.

# EMDR- (eye, movement, desensitization, reprocessing)

- Trajtimi me EMDR i cili ka një *protokoll standard* dhe kalon në tetë faza.
- Në fazën e *Desensibilizimit*, ne i kërkojmë klientit të zgjedhë një kujtim traumatik dhe të përqendrohet te imazhi më i keq i këtij kujtimi.
- Më pas, fillojmë të lëvizim gishtat majtas-djathtas dhe ai e ndjek këtë lëvizje me sy. Klienti mund ta ripërjetojë kujtimin ashtu siç e ka përjetuar në të shkuarën. Nëse ripërjetimi është i fortë, ai ka të drejtë të thotë “NDAL”. Po duke qenë klientët ndihen të sigurt në terapi për ripërpunimin e ngjarjes, pothuajse askush nuk ndalon. Procesi drejtohet nga klienti, ndërsa ne shërbejmë si udhërrëfyes që e drejtojmë në këtë udhëtim, duke inkurajuar kalimin e tij në shtigje të vështira..

# Po pse zgjedhim një kujtim traumatik?

Organizimi ynë është ndërtuar në atë mënyrë që t'i asimilojë informacionet e reja duke u rikthyer në një gjendje adaptive (në ekuilibër).

Ne jemi të pajisur me një sistem që quhet *Sistemi i Përpunimit Adaptiv të Informacionit*.

Mirëpo, nëse një ngjarje na shqetëson aq sa nuk mund ta përballojmë, ky sistem natyror dëmtohet.

Ngjarja traumatike mbetet e papërpunuar, në një gjendje “të ngrirë”, nuk integrohet në rrjetin e kujtesës në tru dhe e ndikon vazhdimisht jetën tonë. Prandaj, në terapinë me EMDR, ne ndihmojmë që ngjarja traumatike të integrohet në kujtesë. Kjo rivendos gjendjen natyrore të ekuilibrit.



# EMDR- (eye, movement, desensitization, reprocessing)

- EMDR mund të përdoret edhe me fëmijë që përjetojnë ankth dhe frikë, me fëmijë që bien pre e talljeve dhe bullizmit, me fëmijë që nuk menaxhojnë dot zemërimin ose që kanë vetëvlerësim të ulët. Me EMDR, fëmijët ia dalin të përballojnë më mirë frikërat (dhe fobitë) e tyre, të kenë një vetëvlerësim më të lartë dhe sjellje të përshtatshme, të mos kenë më probleme me gjumin ose makthe, të mos kenë më vështirësi në të nxënë e me radhë.
- EMDR përdoret me sukses edhe për trajtimin e çrregullimeve, si: vonesa zhvillimore, Autizmi, Sindroma Doën dhe ADHD (Çrregullimi i Vëmendjes me Hiperaktivitet).

# Dhuna në shkolla

- Organizata Botërore e Shëndetësisë e përcakton dhunën si: përdorimi i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike ose psikologjike, kërcënuese ose aktuale, kundër vetes, ndonjë personi tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti që ose rezulton ose ka mundësi të madhe të rezultojë me lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, zhvillim jo normal ose privim (ëHO fi-006).
- Dhuna është: • e dëmshme ose dëmtuese, ose të paktën kërcënon me lëndime; dhe • ka për qëllim (dëmtim ose lëndim aksidental të shkaktuar nga ndokush që zakonisht nuk e mendon si të dhunshme)

# Dhuna

- Shumica e statistikave tregojnë se numri i viktimave nga dhuna shpesh ulet me moshën gjatë viteve shkollore (Smith 2003).
- Kjo mund të jetë për shkak se viktimat potenciale bëhen relativisht të fortë dhe më të aftë për t'i ikur dhunës.
- Megjithatë, të qenurit një veprues i dhunës paraqet rritje në adoleshencën e mesme ose të vonshme.
- Sjelljet e thyerjes së rregullave dhe marrjes së rrezikut në përgjithësi bëhen më të zakonshme dhe më shpesh të sanksionuara nga grupi i shokëve të cilët kalojnë në vitet e adoleshencës

# Faktorët që ndikojnë në nivelin e dhunës

- Tensionet racore janë dukshme në shumë shtete dhe këto mund të reflektohen në shkolla.
- Pakicat etnike dhe nxënësit emigrant mund të përjetojnë ngacmim racor, dhe vetë të rinjtë mund të sjellin besime dhe përvoja të ndryshme të deprivimit dhe frustrimit në shkollë.
- Faktorët e historisë familjare zakonisht është zbuluar të jenë shumë të rëndësishme në nxitjen e dhunës (Oléus 1993), me prindërit të cilët janë vetë të dhunshëm, mungesë të ngrohtësisë prindërore dhe monitorim të dobët të sjelljes së fëmijës është më e ngjarë të kenë fëmijë të cilët shfaqin sjellje të dhunshme, agresive ose represive në shkollë.
- Ka disa shenja se kujdesi i tepruar prindëror, në të kundërtën, mund të parasheh rrezikun që fëmija të bëhet viktimë e dhunës.
- Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe aftësi të kufizuara mund të jenë në rrezik më të madh për të qenë viktimë të dhunës (Nabuzoka 2000).

# Veprimet që reduktojnë dhunë në shkollë

- Politikat e shkollës dhe rregullat e klasës.
- Masat e përgjithshme parandaluese.
- Përmirësimi i mjedisit shkollor për reduktimin e dhunës.
- Programet dhe aktivitetet mësimore.
- Mbështetja për viktimat e dhunës.
- Siguria në shkollë dhe masat e sigurisë.
- Trajnimi i personelit të shkollës.

# Ekstremizimi/Edukimi në shkolla ndihmon të rinjtë të:

- zhvillojnë aftësinë e komunikimit dhe ato ndërpersonale për të komunikuar
- Zhvillojnë aftësinë e të menduarit kritik për të shqyrtuar dhe qartësuar ekstremizimin, besimet ekstremiste dhe legjitimiteti
- Zhvillojnë aftësi për t'iu rezistuar ideve e qendrimeve ekstremiste
- Formojë qytetarë të informuar për të marrë pjesë në aktivitete parësore

# Mësuesi:

- Luan rol parësor në parandalimin e ekstremizmit
- Janë agjentë ndryshimi pasi janë në kontakt të përditshëm me të rinjtë dhe shërbejnë si model
- Mund të jenë të parët që identifikojnë shenjat e ekstremizmit
- Shërbejnë si urë lidhëse midis shkollës, familjes dhe komunitetit
- Mësuesit dhe gjithë personeli bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, psikologu, pedagogë, prindërit.

# Mësuesi si edukator dhe mësuesi mbështetës:

- Të ketë formimin e duhur për trajtimin e problemit
- Të motivohet dhe të ketë kushte të përshtatëshme mësimdhënëse
- Të mbështeten që të jenë të vëmendshëm ndaj sfidave personale të nxënësve të cilët janë në kërkim të vetvetes
- Të kenë mbështetjen psiko-sociale për të përballuar sfidat e lidhura me rolin e tyre konstruktiv në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

# Rasti studimor 1

Rasti: Dhuna psikologjike shpesh ka shumë forma.

- Një nxënës i ardhur nga zona lufte është i heshtur, i traumatizuar. Ndërkohë ai vuan psikologjikisht pasi ai ndjehet i bullizuar nga bashkëmoshatarët dhe mësuesit pasi përfaqëson një komunitet të paragjykuar nga të tjerët sepse vjen nga një ambjent i panjohur. Kjo e bën të qëndrojë i vetëm, i mbyllur dhe potenciali akademik i tij është në nivel të ulët. Ky bullizim shkakton revoltë brenda nxënësit që mund të bëhet dhe burim dhunë fizike mes nxënësish, ndërkohe dhe vetëvlerësm të ulët.
- Punë në grupe:
- Si duhet të veprojë drejtorja e shkollës? Listoni disa nga hapat.
- Si duhet të veprojnë mësuesit? A duhet një strategji vepruese për këtë fëmijë? Listoni disa nga hapat.
- Cilët janë aktorët që duhet të bëhen pjesë?

# Rasti studimor 2

- Rasti: Një nxënës duke ardhë nga zona të izoluara lufte ka vështirësi në të folur shqip por sidomos në të shkruar. Kjo jo vetëm që e vë në vështirësi për arritje akademike por ndjejnë dhe peshën psikologjike të ndryshëm nga të tjerët pasi nuk ndjekin dot veprimtaritë mësimore në të shkruar. Mësuesi i vetëm ka vështirësi të realizojë pjesëmarrjen e plotë të nxënësit pasi ka ngarkesë mësimore të përditshme.
- Atëherë si duhet të veprojë shkolla?
- Drejtoria e shkollës çfarë duhet të planifikojë?
- Po mësuesi vetë ne raste të tilla?
- Listoni vështirësitë që mund të ketë nxënësi dhe zgjidhjen.

# Rasti studimor 3

- Rasti: Një nxënës i ardhur nga zonë lufte është i mbyllur në vetevete, ai nuk di gjuhën shqipe dhe ka vështirësi në të nxënë. Mosangazhimin e tij është jo vetëm në procesin mësimor por dhe atë shoqëror. Pamundësia e komunikimit kufizon afrimin e tij me bashkëmoshatarët duke krijuar distancë sociale, dhe paragjykim ndaj tij nga shokët meqë vjen nga një zonë lufte dhe e panjohur.
- Punë në grup:
- Si duhet të veprojë drejtorja e shkollës?
- Cili është plani veprues?
- Cilët janë aktorët që duhet të bëhen pjesë?

# Shkolla duhet :

- Të evidentojë shkallën e mbështetjes që i nevojitet fëmijëve të kthyer;
- Drejtoria e shkollës të ndjekë me vëmendje ecurinë dhe mbështetjen e fëmijëve;
- Mësuesi kujdestar, mësuesi ndihmës, punonjësi i shërbimit psiko-social, pedagogë, komuniteti duhet të jenë pjesë e procesit;
- Ngritja e një strukture mbështetëse për shkollën me profesionistë të fushave të ndryshme mund të mbështetëse aktivitete të ndryshme në integrimin e tyre;
- Programe të veçanta për fëmijët e kthyer si në aspektin gjuhësor dhe programor në mënyrë integrimin sa më shpejtë të tyre;
- Trajnim për mësuesit me qëllim njohjen sa më mirë të specifikës së problemit të ekstremizimit dhe luftës.



# Feedback i trajnimit

Faleminderit!



# Literatura

Save the Children, (2013), Arsimi Gjithpërfshirës në Shqipëri.

Linku: [https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Inclusive%20Education%20in%20Albania%20\(in%20Albanian\).pdf](https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Inclusive%20Education%20in%20Albania%20(in%20Albanian).pdf)

UNICEF (2013) “Udhëzuesi i gjithpërfshirjes në arsim”

Linku: [http://observator.org.al/ep-content/uploads/2015/09/UDHEZUES\\_GJITHEPERFSHIRJA\\_SHQK\\_2\\_18-02-15.pdf](http://observator.org.al/ep-content/uploads/2015/09/UDHEZUES_GJITHEPERFSHIRJA_SHQK_2_18-02-15.pdf)

Save the Children, (2008) Module Trajnimi.

Karaj, Dh., (2008), Psikologji e zbatuar në mësimdhënies, Tiranë.

Mekolli, S., (2015) Dhuna dhe Siguria në shkolla, IPK.

Albanian Disability Rights Foundation and AMShC, The Implementation of the Action Plan of the National Strategy on People with Disabilities in 2010: Monitoring Report, May 2011

Booth, Tony dhe Mel Ainscoë, Index for Inclusion: Developing Learning and Participation in Schools, CSIE, Bristol, revised edition 2002.

Closs, A., Nano, V. dhe Ikonimi, E. “Unë jam si ju” Botim i Save the Children. Tiranë, 2003

Dethilleul, Y., Hoxha, A., Llambi, S., Gjermani, L., Kokomeri, I & Kita, L. (2000) Albania: Issues and Challenges in Education Governance. Tirana: World Bank

Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar, 2013

Ikonimi Estevan, “Hartimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për arsimim gjithpërfshirës” 2010

Ligji Nr. 69/2012/2015, Për arsimin Parauniversitar. 2015

Nano, V. Shkolla Shqiptare Drejt Proceseve Integruese. Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Tiranë, 2002

MAS. “Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2015-2021

